



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.133

13 gusht

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF dhe MPÇSSHB nr.1406, datë 30.7.2008	Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të vendimit të këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit””	5921
Udhëzim i MF dhe MMPAM nr.23, datë 7.8.2008	Mbi procedurat e furnizimit të anijeve të peshkimit me gazoil pa akcizë	5927
Udhëzim i MASH nr.28, datë 28.7.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.25, datë 7.7.2008 “Për kriteret profesionale dhe procedurat e konkursit, për zgjedhjen e trembëdhjetë anëtarëve ekspertë të këshillit kombëtar të arsimit parauniversitar”	5934
Udhëzim i MASH nr.30, datë 29.7.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8, datë 6.5.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999	5935
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1590, datë 4.8.2008	Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional	5936
Vendim i BSH nr.42, datë 16.7.2008	Për miratimin e rregullores “Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN)”	5941
Vendim i BSH nr.43, datë 16.7.2008	Për miratimin e rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat” ..	5952
Vendim i KQZ nr.76, datë 1.8.2008	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, komuna Kashar, të datës 27.7.2008	5959

Vendim i ERE nr.88, datë 6.8.2008	Për licencimin e shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k	5960
Vendim i ERE nr.89, datë 6.8.2008	Për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.....	5961
Vendim i ERE nr.90, datë 6.8.2008	Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k... ..	5962
Vendim i ERE nr.91, datë 6.8.2008	Për licencimin e shoqërisë “Muso Hec Qytezë” sh.p.k.....	5963
Vendim i ERE nr.92, datë 6.8.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hidro Invest 1” sh.p.k.....	5964
Kërkesë e MPPTT nr.2257/1, datë 28.7.2008	Për shpronësim publik, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Tepelenë (seksioni i parë).....	5965

UDHËZIM
Nr.1406, datë 30.7.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM
PËR DHËNIEN E PËRFITIMIT, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.869, DATË 18.6.2008 “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË
14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT””**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Pagesa e paaftësisë, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008, do të jepet nga bashkia/komuna, ku invalidi ka vendbanimin.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore lëshon vërtetimin për shkallën e invaliditetit, të përcaktuar nga KMCAP-i, sipas modelit nr.1 (Invalid i plotë nga sëmundje të përgjithshme), modelit nr.2 (Invalid i pjesshëm nga sëmundje të përgjithshme), modelit nr.3 (Invalid i plotë nga aksidente e sëmundje profesionale), modelit nr.4 (Invalid i pjesshëm nga aksidente e sëmundje profesionale).

3. Për invalidët që kanë përfituar shtesë, e paaftësisë deri më 1.7.2008, pranë komunave dhe bashkive do të vazhdojnë ta tërheqin pagesën me ato dokumente që kanë dorëzuar më parë. Për rastet kur komisionohen ose janë invalidë për herë të parë do të pajisen me vërtetimin e ri sipas modeleve bashkëlidhur.

4. Në rastet kur KMCAP vendos për ndryshimin e grupit të invalidit, ndryshimi i masës së përfitimit bëhet në muajin pasardhës (një muaj pas komisionit) të përcaktuar sipas vërtetimit tip të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi.

5. Për personat që komisionohen për herë të parë dhe përfitojnë statusin e invalidit të punës, pagesa e paaftësisë fillon në muajin pasardhës pas daljes në KMCAP të përcaktuar sipas vërtetimit tip, në pikën 2 të këtij udhëzimi.

6. Për rastet kur invalidi ka ndryshuar vendbanimin pas komisionimit nga KMCAP-ja, e rrethit origjinë, ka të drejtë të kërkojë pagesën e paaftësisë në vendbanimin e ri, mbasi është rikomisionuar në vendbanimin e ri.

7. Pagesa e paaftësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008, u jepet invalidëve, pavarësisht nga të ardhurat e tjera që ato përfitojnë nga pagesat e mbrojtjes shoqërore dhe nuk llogariten në të ardhurat e familjes për efekt të përfitimit të ndihmës ekonomike.

8. Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore dërgojnë çdo muaj në zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror, listën e përfituesve të ndarë sipas pikës 1/a, 1/b, 1/c dhe 1/ç të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.6.2008.

9. Zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror programojnë nevojat për fonde për çdo bashki/komunë dhe inspektojnë zbatimin e pagesave nga bashkitë/komunat për invalidët përfitues.

10. Zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror dërgojnë në çdo bashki/komunë listën e invalidëve të punës të vlerësuar nga KMCAP-të.

11. Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë njëherë në tre muaj dërgon në zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror, listën e invalidëve të punës të pajisur me dokumentin e identifikimit sipas nenit 4 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, i ndryshuar.

12. Administratorët e bashkisë/komunës përllogarisin nevojat për fondet dhe përgatisin projektvendimin për miratim në këshillin e bashkisë/komunës për pagesën e paaftësisë për invalidët e punës.

13. Këshilli i bashkisë/komunës, miraton fondin për pagesën e paaftësisë për invalidët e punës.

14. Zyra e financës e bashkisë/komunës, mbi bazën e vendimit të këshillit bashkiak/komunal, përpilon listëpagesën e veçantë për invalidët e punës.

15. Pagesa e paaftësisë tërhiqet çdo muaj në bashki/komunë ku invalidi i punës ka vendbanimin, duke paraqitur dokumentin e identitetit.

16. Në rastet kur invalidi i punës, për shkaqe që nuk varen prej tij, kur: i) komisioni është mbledhur me vonesë; ii) invalidi ka qenë i sëmurë apo për kurim brenda apo jashtë vendit, dhe këto arsye argumentohen me dokumentacion vërtetues, invalidi gëzon të drejtën e përfitimit të pagesës deri në tre muaj vonesë.

17. Administratorët shoqërorë të bashkisë/komunës krijojnë për çdo invalid pune një dosje të veçantë ku depozitohen dokumentet përkatëse që vërtetojnë paaftësinë e tyre.

18. Personat që pretendojnë të përfitojnë pagesën e paaftësisë si invalid pune, paraqesin në bashkinë/komunë ku kanë vendbanimin, çdo fillim viti dhe pas çdo komisionimi apo rikomisionimi, dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesën për përfitimin e paaftësisë si invalid pune;
- b) certifikatë personale me fotografi;
- c) Vërtetim në origjinal të lëshuar nga drejtoria rajonale e sigurimit shoqëror, sipas modeleve nr.1, 2, 3, 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Udhëzimi nr.682/4, datë 18.6.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitimin e paaftësisë nga personat me statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqerore



VËRTETIM

Nr. _____, datë _____ 200

PËR INVALIDITET TË PLOTË NGA SËMUNDJE TË PËRGJITHSHME

Me të cilin vërtetohet se z/znj. _____, përfiton pension invaliditeti të plotë nga sëmundje të përgjithshme, me diagnozë _____ dhe dosje pensioni me nr. _____, mase/pensioni mujor _____ lekë.

Këtë pension invaliditeti e përfiton nga data _____ deri më datë _____ dhe nga data _____ ka dalë në pension pleqërie.

Përgjegjësi i sektorit të ekspertizës

K/degës përfitimeve

Drejtori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqerore



VËRTETIM

Nr. _____, datë _____ 200

PËR INVALIDITET TË PJESSHËM NGA SËMUNDJE TË PËRGJITHSHME

Me të cilin vërtetohet se z/znj. _____, përfiton pension invaliditeti të pjesshëm nga sëmundje të përgjithshme, me diagnozë _____ dhe dosje pensioni me nr. _____, masë pensioni mujor _____ lekë.

Këtë pension invaliditeti e përfiton nga data _____ deri më datë _____ dhe nga data _____ ka dalë në pension pleqërie.

Përgjegjësi i sektorit të ekspertizës

K/degës përfitimeve

Drejtori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqerore



Modelar 3

VËRTETIM

Nr. _____, datë _____ 200

**PËR INVALIDITET TË PLOTË NGA AKSIDENTE NË PUNË OSE SËMUNDJE
PROFESIONALE**

Me të cilin vërtetohet se z/znj. _____, përfiton pension invaliditeti të plotë nga aksident në punë, sëmundje profesionale me diagnozë _____ dhe dosje pensioni me nr. _____, masë pensioni mujor _____ lekë.

Këtë pension invaliditeti e përfiton nga data _____ deri më datë _____ dhe nga data _____ ka dalë në pension pleqërie.

Përgjegjësi i sektorit të ekspertizës

K/degës përfitimeve

Drejtori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqerore



Modelar 4

VËRTETIM

Nr. _____, datë _____ 200

**PËR INVALIDITET TË PJESSHËM NGA AKSIDENTE NË PUNË OSE SËMUNDJE
PROFESIONALE**

Me të cilin vërtetohet se z/znj. _____, përfiton pension invaliditeti të pjesshëm nga aksident në punë ose sëmundje profesionale me diagnozë _____ dhe dosje pensioni me nr. _____, masë pensioni mujor _____ lekë.

Këtë pension invaliditeti e përfiton nga data _____ deri më datë _____ dhe nga data _____ ka dalë në pension pleqërie.

Përgjegjësi i sektorit të ekspertizës

K/degës përfitimeve

Drejtori

UDHËZIM

Nr.23, datë 7.8.2008

**MBI PROCEDURAT E FURNIZIMIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT ME GAZOIL PA
AKCIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 e, të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, të shkronjës “x” të nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave datë 1.5.2008 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1050, datë 21.7.2008 “Për furnizimin e anijeve të peshkimit me gazoil, pa akcizë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave:

UDHËZOJNË:

I. Të përgjithshme

1. Ky udhëzim zbatohet për furnizimin e anijeve shqiptare të peshkimit me gazoil pa akcizë, si furnizim bordi, si dhe ndaj subjekteve që furnizojnë anijet e peshkimit sipas ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar.

2. Formularët dhe shënimet e paraqitura në shtojcat bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pjesë e udhëzimit dhe kanë fuqi të njëjtë ligjore.

3. Shoqëritë furnizuese të karburantit (gazoilit) për anijet e peshkimit janë vetëm shoqëritë aksionare, të licencuara në bazë të nenit 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të cilat disponojnë magazina doganore.

4. Do të furnizohen me karburant pa akcizë, por me TVSH, si furnizim bordi, të gjitha anijet e peshkimit, persona juridikë dhe fizikë të cilët:

a) janë të pajisur me licencë peshkimi;

b) janë të regjistruar pranë organeve tatimore dhe shesin prodhimin e tyre me faturë tatimore me TVSH;

c) janë të regjistruar në regjistrin detar;

d) janë të siguruar sipas ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, pas miratimit të tarifave përkatëse të sigurimit nga autoriteti kompetent;

e) kanë të punësuar një numër jo më pak se:

a) (dy) persona për anijet deri në 15 metra gjatësi;

b) (tre) persona për anijet 15.01-në 24 metra gjatësi;

c) (katër) persona për anijet mbi 24.01 metra gjatësi,

të regjistruar për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

f) janë subjekte aktive të regjistruara, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore.

Subjektet e tjera, jashtë këtyre pikave, përjashtohen nga skema e furnizimit me karburant. Magazina doganore ndërpret furnizimin me gazoil pa akcizë të subjekteve të peshkimit, vetëm me njoftimin zyrtar të organit tatimor apo atij doganor.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon zyrtarisht te të gjitha subjektet furnizuese, të cilat kanë magazina doganore karburanti, listën e subjekteve aktive të peshkimit të cilat janë të regjistruar në degën e tatimeve si subjekte të TVSH-së, si dhe të gjitha ndryshimet periodike të tyre.

6. Drejtoria e Politikave të Peshkimit dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, jo më vonë se data 31 janar të çdo viti, listën me emrat e subjekteve të licencuara të peshkimit, si dhe çdo ndryshim periodik në këtë listë.

II. Procedurat dhe skema e furnizimit

7. Përfaqësuesi i shoqërisë furnizuese të gazoilit pa akcizë duhet të njoftohet nëpërmjet një kërkesë me shkrim nga subjekti i peshkimit, i cili kërkon të furnizohet me karburant, sipas modelit të kërkesës bashkëlidhur në shtojcën 2 të këtij udhëzimi.

8. Të paktën një ditë përpara furnizimit me gazoil të subjekteve të peshkimit, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë furnizuese të gazoilit, pa akcizë, duhet:

a) të njoftojë degën e doganave ku do të bëhet furnizimi, për furnizimin e anijeve të peshkimit me gazoil për nevojat e peshkimit;

b) të evidentojë në regjistrin ekzistues të ngarkim-shkarkimit të karburantit, lëvizjen e karburantit nga magazina doganore, sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të Ministrit të Financave apo Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

9. Të gjitha lëvizjet e gazoilit pa akcizë për anijet e peshkimit, ndërmjet magazinave doganore të miratuara në Republikën e Shqipërisë dhe subjekteve të peshkimit, duhet të shoqërohen nga dokumenti i transitit T1 dhe nga faturat e shitjes e lëshuar nga magazina doganore (subjekti furnizues) dhe e nënshkruar nga përfituesi. Me mbërritjen në destinacion (zona doganore portuale ku ndodhet anija e peshkimit) kryhet procedura e zhdoganimit nga dogana pritëse (Dokumenti IM4). Malli quhet i çliruar pas shkarkimit të karburantit nga autoboti në serbatorin e anijes së peshkimit. Përgjegjës për këtë procedurë është subjekti përfitues nën mbikëqyrjen e doganierit të kontrollit fizik dhe sipas rastit atij të antiknabandës detare.

10. Gazoili, i blerë nga subjektet e peshkimit, nga momenti i çlirimit nga regjimi i magazinës

doganore, konsiderohet në ngarkim të subjektit të peshkimit.

11. Subjekti i peshkimit ka për detyrë të justifikojë pranë organeve tatimore, sasinë e karburantit të furnizuar nëpërmjet faturave tatimore të gazoilit (IM4) faturave tatimore me TVSH të produktit të peshkimit të shitur, regjistrin të karburantit të anijeve të peshkimit ku janë shënuar sasi të furnizuara, konsumi dhe lëvizjet e anijes së peshkimit.

12. Vlera totale e karburantit të furnizuar (konsumuar) gjatë një 6-mujori nuk mund të jetë më e madhe se 80% e vlerës totale të produktit të peshkimit të shitur me faturë tatimore me TVSH, gjatë kësaj periudhe.

13. Rakordimi, për efekt të llogaritjeve të kufizimit në pikën 12 më sipër, do të bazohet:

a) Kur sasia e gazoilit pa akcizë të furnizuar është konsumuar nga subjekti i peshkimit totalisht në 6-mujorin e parë nga data e fillimit të funksionimit të skemës, rakordimi do të bëhet ndërmjet vlerës totale të faturave të blerjes së gazoilit, pa akcizë, dhe vlerës totale të produkteve të peshkimit të shitura me faturë tatimore me TVSH.

b) Kur sasia e furnizuar e gazoilit nuk është konsumuar e gjitha brenda 6-mujorit të parë, rakordimi do të kryhet mbi bazën e krahasimit ndërmjet vlerës totale të faturave të gazoilit të konsumuar dhe vlerës totale të produkteve të peshkimit të shitura me faturë tatimore me TVSH.

14. Vlera totale e gazoilit të konsumuar nga subjekti i peshkimit, do të përcaktohet duke iu referuar regjistrin të anijes së peshkimit, kopje e të cilit depozitohet pranë degës së tatimeve nga subjekti i peshkimit, konsumit të karburantit (sasisë së konsumuar), çmimit të faturave korresponduese të gazoilit, si dhe inventarit të karburantit, vlera (sasia) e të cilit llogaritet nga punonjësi tatimor mbi bazën e metodës FIFO (hyrje e parë, dalje e parë). Duke përdorur këtë metodë, nga sasia totale e gazoilit të faturuar, pasi zbritet sasia e gazoilit të konsumuar nga subjekti i peshkimit, (sipas regjistrin të konsumit të karburantit të anijes, orët e punës x konsumin orar/mes) sasia e mbetur e karburantit gjendet në fund të periudhës vlerësohet me çmimet korresponduese të sasive përkatëse sipas datave të furnizimit dhe rakordohet me subjektin e peshkimit.

15. Diferenca (sasia gjendje) e vlerësuar me çmimet korresponduese të blerjes së karburantit do të mbartet për periudhën e ardhshme ushtrimore dhe do të mbahet në konsideratë për rakordim gjatë 6-mujorit në vijim.

16. Inspektori tatimor, për efekt rakordimi, për të kryer inventarin e gjendjes faktike të karburantit në serbatorin e anijes kërkon bashkëpunim me antikontrabandën detare dhe ndërmjet këtij të fundit dhe subjektit të peshkimit mbahet procesverbal i përkatës. Kopja origjinale e procesverbalit i dorëzohet inspektorit tatimor, dhe pas këtij certifikimi, ndërmjet organit tatimor dhe subjektit të peshkimit, nënshkruhet akti i rakordimit.

17. Të paktën një herë në dy muaj, subjekti i peshkimit depoziton tek inspektori i akcizës në degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, kopje të faturave tatimore të produktit të peshkimit të shitur, si dhe deklaratat IM4 të gazoilit të furnizuar.

18. Inspektori i tatimeve krijon databasin përkatës për çdo subjekt peshkimi. Database përmban të gjitha të dhënat e subjekteve të peshkimit, datat e furnizimit, sasinë dhe vlerën e produktit të peshkimit të shitur me faturë tatimore, sasinë dhe vlerën e karburantit të furnizuar, si dhe sasinë dhe vlerën e karburantit të konsumuar.

19. Referuar database-it, inspektori i tatimeve ndjek ecurinë e furnizimit me karburant të subjekteve të peshkimit dhe detyrimisht 6 muaj pas furnizimit të parë të subjektit të peshkimit, subjektet e peshkimit dhe degët e tatim-taksave të rrethit përkatës bëjnë rakordimin midis faturave të gazoilit pa akcizë të blerë (konsumuar) dhe faturave të peshkut të shitur me faturë tatimore me TVSH. Subjektet e peshkimit me kërkesën e tyre mund të bëjnë rakordimin e mësipërm edhe në një afat më të shkurtër.

20. Nëse subjektet e peshkimit tejkalojnë afatin e mësipërm të rakordimit, degët e tatim-taksave të rrethit përkatës urdhërojnë ndërprerjen e menjëhershme të furnizimit me gazoil pa akcizë për subjektin e peshkimit, deri në momentin e kryerjes së rakordimit. Nëse edhe pas kësaj ndërprerjeje, ky rakordim nuk kryhet brenda një periudhe 1-mujore, degët e tatim-taksave të rrethit përkatës fillojnë automatikisht kontrollin e subjektit të peshkimit.

21. Në rast se vlera e të gjitha faturave të karburantit të konsumuar (faturuar) pa akcizë për një 6-mujor është më e vogël ose e barabartë me 80% të vlerës totale të faturave të produkteve peshkore të shitura me TVSH për këtë periudhë, inspektori tatimor i akcizës, nënshkruan aktin e rakordimit me subjektin e peshkimit dhe mbi bazën e parimit “heshtja nënkupton miratim” pra, pa qenë i nevojshëm

konfirmimi zyrtar, magazina doganore vijon furnizimin me gazoil pa akcizë, deri në njoftimin zyrtar për ndërprerjen e tij nga organi tatimor.

22. Në rast se një subjekt juridik peshkimi disponon më shumë se një mjet peshkimi (anije) dhe këto mjete identifikohen me një numër të vetëm regjistrimi (NIPT), por me emra të ndryshëm, procedura e rakordimit ndërmjet këtij subjekti peshkimi dhe organit tatimor do të jetë e njëjtë sikur po rakordohet për një mjet të vetëm, pra, rakordimi do të kryhet duke krahasuar vlefën totale të gazoilit pa akcizë, të furnizuar (konsumuar) për të gjitha mjetet e këtij subjekti për periudhën e rakordimit me vlefën totale të produktit final të peshkimit, të shitur me faturë tatimore me TVSH, të faturuar nga të gjitha këto mjete, për të njëjtën periudhë rakordimi.

23. Dega e tatimeve është e detyruar të njoftojë me shkrim subjektin furnizues të karburantit për ndërprerjen e furnizimit, në momentin kur konstaton se vlera e të gjitha faturave të karburantit të furnizuar (konsumuar) pa akcizë është më e madhe se 80% e vlerës totale të faturave të produkteve peshkore të shitura, për periudhën 6-mujore të rakorduar. Nëse organi tatimor nuk e njofton zyrtarisht subjektin furnizues për ndërprerjen e furnizimit me gazoil të subjektit të peshkimit, përgjegjësia mbetet tek organi tatimor dhe ndaj personit përgjegjës zbatohen sanksionet sipas Kodit të Procedurave Administrative.

24. Në rast se subjekti i peshkimit, në fund të periudhës 6-mujore të rakordimit rezulton me TVSH të kreditueshme, referuar procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për TVSH-në”, organet tatimore kryejnë detyrimisht rimbursimin automatik të shumës së TVSH-së së kreditueshme.

25. Subjekti i peshkimit, i cili, pas rakordimit me organin tatimor, rezulton me tejkalim të kufirit 80% të vlerës së gazoilit të furnizuar (konsumuar) ndaj vlerës së produktit të peshkimit të faturuar në shitje për periudhën e rakorduar, për t’u rifutur në skemën e përfitimit të furnizimit me gazoil, pa akcizë, duhet të paguajë për llogari të organit tatimor, të gjithë vlerën e akcizës së përfituar për sasinë e tejkaluar të faturimit (konsumit) të gazoilit, si dhe vlerën e TVSH-së së llogaritur, që i korrespondon kësaj sasive të tejkaluar të karburantit. Nga momenti (data) e shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, subjektit të peshkimi i lind e drejta të rifutet në skemë, për një periudhë tjetër 6-mujore.

26. Gazoili duhet të jetë i ngjyrosur me ngjyruesin fiskal të standardit të BE-së, (Solvent Yellow 124 me emër shkencor N-etil-N-ë2-ë1-(2-isobutossietossi) etil]-4-(fenilazo) aniline], në momentin e lëvizjes së autobotit, në magazinën doganore nisëse. Niveli i ngjyrimit është i barabartë me jo më pak se 6 mg për litër gazoil dhe jo më shumë se 9 mg për litër.

27. Anijet e peshkimit që kanë të drejtë të furnizohen me karburant pa akcizë sipas pikës 4 të këtij udhëzimi duhet të jenë të pajisura me një regjistër të karburantit për anijet e peshkimit (shtojca 1 e këtij udhëzimi) në të cilin të jenë të regjistruara sasisë e furnizuara, dhe konsumi i karburantit pa akcizë. Regjistri përbëhet nga tri pjesë:

a) Në pjesën e parë shënohen karakteristikat e anijes së peshkimit, sipas dokumentacionit të anijes së peshkimit që mbahet në bordin e saj dhe me të dhënat teknike të motorit, konsumit mesatar orar në raport me fuqinë motorike.

b) Në pjesën e dytë shënohen ngarkim-shkarkimi i karburantit të kryer dhe të dhënat e kontratës së nënshkruar midis anijes së peshkimit dhe furnizuesit.

c) Në pjesën e tretë shënohen orët e punës dhe konsumi i karburantit.

Shënimet në pjesën e parë duhet të vërtetohen nga kapiteneria e porteve sipas të dhënave të regjistrit detar; shënimet në pjesën e dytë nga përfaqësuesi i doganës dhe kapiteni i anijes, sipas njoftimit sipas pikës 8.a; shënimet në pjesën e tretë nga kapiteni i anijes së peshkimit. Kapiteni i anijes së peshkimit ruan në bord të gjitha nisjet dhe hyrjet e kryera nga kapiteneria e porteve të cilat janë pjesë e dokumentacionit të anijes së peshkimit.

28. Automjeti ose autoboti me të cilin do të transportohet gazoili pa akcizë, duhet të jetë i tipit të miratuar, si dhe të plotësohen kushtet e plumbosjes dhe çplumbosjes, sipas procedurave të miratuara në aktet nënligjore në fuqi.

III. Kontrolli për administrimin e skemës së shpërndarjes së karburantit.

29. Të paktën një herë në gjashtë muaj bëhet inventari i lëvizjeve të karburantit në shoqëritë furnizuese.

30. Antikontrabanda detare nën autoritetin doganor mund të verifikojë vërtetësinë e regjistrimeve në regjistrat e furnizimit të anijeve të peshkimit dhe të konsumit të karburantit. Pas çdo kontrolli në regjistrat vendoset shënimi mbi kontrollin e kryer dhe mbahet procesverbali përkatës. Në rast shkeljeje, njoftohet zyrtarisht organi tatimor i rrethit përkatës të subjektit të peshkimit.

31. Organet tatimor (strukturat përkatëse të hetimit tatimor) mund të kontrollojnë në çdo moment pikat e shitjes me pakicë të karburanteve, si dhe automjetet, për karburant të denaturuar (me ngjyrosës), i cili përdoret për anijet e peshkimit.

32. Në rast se konstatohen shkelje të rregullave për administrimin dhe menaxhimin e këtij procesi, pavarësisht nga procedimi penal, organet doganore dhe tatimore kërkojnë zhdëmtimin e dëmit nga subjektet apo individë që shkelin rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim, sipas dispozitave të nenit 44, germa “a” dhe “b” të ligjit “Për akcizat”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9945, datë 26.6.2008 “Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar.”.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

SHTOJCA 1

REGJISTËR I FURNIZIMIT ME GAZOIL PA AKCIZË

MOTOBARKA: _____

PORTI: _____

MOTOBARKA _____

PRONARI _____

NR. LICENCËS SË PESHKIMIT _____

NR. I REGJISTRIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT _____

TË DHËNAT E MOTORIT

MARKA E FABRIKIMIT DHE LLOJI _____

FUQIA (HP) _____

VITI I PRODHIMIT _____

KONSUMI MESATAR I KARBURANTIT (LIT/ORE) _____

GJATËSIA E MJETIT TË PESHKIMIT _____

KAPITENERIA E PORTIT

VULA

FURNIZIMI ME KARBURANTE

DATA	Dokumenti shoqërues		Sasia e karburantit të furnizuar	Firma e kapitenit	Firma e punonjësit të doganës që ka bërë regjistrimin e furnizimit
	Numri	Data	Litra		

KONSUMI I KARBURANTEVE

[illegible]

				Totali		

SHTOJCA 2

KËRKESË

_____ me __. __. 20__

Drejtuar: Subjektit furnizues _____ me magazinë doganore në _____

Me numër NIPT _____

Me adresë _____

Nga: Subjekti i peshkimit _____

Me numër NIPT _____

Përfaqësues i anijes së peshkimit _____

Me numër regjistri në Regjistrin e Mjeteve Lundruese të Peshkimit ALB _____

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1050, datë 21.7.2008 “Për furnizimin e anijeve të peshkimit me gazoil pa akcizë”, pikës 7 të udhëzimit nr.____ datë _____2008, subjekti i peshkimit _____ kërkon të furnizohet me gazoil pa akcizë për anijen e peshkimit _____ në sasinë prej _____ (sasia në fjalë) litra. Ky furnizim do të kryhet me datë __.__.20__, pranë magazinës suaj doganore, në orën __.__.

Për sa më sipër lutemi, njoftimin e degës së doganave _____ për ndjekjen e procedurave të furnizimit të gazoilit për anijen e peshkimit.

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit të peshkimit

Firma

UDHËZIM
Nr.28, datë 28.7.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 7.7.2008 “PËR KRITERET
PROFESIONALE DHE PROCEDURAT E KONKURSIT, PËR ZGJEDHJEN E
TREMBËDHJETË ANËTARËVE EKSPERTË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 54 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Pika V, bëhet si më poshtë:

V. Konkursi të bëhet më 25 shtator 2008, nëpërmjet dosjeve të dorëzuara brenda datës 20 shtator 2008.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

UDHËZIM
Nr.30, datë 29.7.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.8, DATË 6.5.1999 “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, NË ZBATIM TË
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.194, DATË 22.4.1999**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.617, datë 21.12.1999 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.596, datë 13.11.2000 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, për interpretim më të drejtë dhe të unifikuar të vendimeve të Këshillit të Ministrave më lart,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr.8, datë 6.5.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, në paragrafin e I, pika “1” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paga e grupit sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës:

- Grupi i I “1”

Me diplomë të shkollës së lartë për mësuesi, por që japin mbi 30% të ngarkesës mësimore lëndë të profilit të tyre. Me diplomë të shkollës së lartë për mësuesi, që japin mësim në klasat kolektive të ciklit të lartë. Me diplomë të shkollës së lartë për degët fizike e biologji dhe japim mësim në klasën e V-të, dy mësues për dy klasë.

- Grupi i II “2”

Me shkollë të mesme pedagogjike:
Me shkollë të mesme profesionale ku fitohet specialiteti për mësuesi.
Diplomë mbi shkollën e mesme.
Punonjësit mësimorë të cilët kanë mbaruar të

paktën 2 vite akademike të shkollës së lartë.
Të gjithë punonjësit mësimorë me diplomë të shkollës së lartë për mësuesi, që japin më pak se 30% të ngarkesës mësimore me lëndë jashtë profilit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë në profil.

Paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

Vjetërsi në punë në profil, do të konsiderohet periudha e punës së kryer në ato vende pune të cilat përcaktohen në udhëzimin nr.2, datë 10.1.2008 “Për vjetërsinë e punës në arsim”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Udhëzimi nr.16, datë 3.10.1991 “Mbi vjetërsinë e punës në arsim për efekt atestimi”, shfuqizohet.

3. Për mësuesit që punojnë larg vendbanimit

Për një zbatim më të drejtë të lidhjes nr.3 “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar që punojnë larg vendbanimit”, të veprohet si më poshtë:

Për paragrafin 1.

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 1500 lekë në muaj, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 4375 lekë në muaj.

Çdo fillim viti mësimor të evidentohen punonjësit mësimorë që punojnë larg vendbanimit nëpërmjet vërtetimeve të pushtetit vendor (nga kryeplaku dhe kryetari i komunës ose bashkisë).

Për punonjësit mësimorë që kryejnë rrugën me transport të siguar nga DAR/ZA-at, masa e shpërblimit mujor për largësi, të jetë sipas distancës në kilometra.

Në rastet kur nuk mund të sigurohet transporti për mungesë infrastrukture, masa e shpërblimit të përcaktohet në raport me largësinë dhe vështirësinë e rrugës.

Në rastet kur mësuesi ndryshon vendbanimin me dëshirën e tij dhe vazhdon të punojë në të njëjtën vend pune, përfiton shpërblimin për largësi vendbanimi vetëm kur DAR/ZA-at nuk kanë mundësi për zëvendësimin e tij.

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm dhe Drejtoria e Planifikimit Buxhetor.

III. Ky udhëzim hyn në fuqi me fillimin e vitit mësimor 2008-2009.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

UDHËZIM

Nr.1590, datë 4.8.2008

PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 23 germa “b” të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Subjekti fizik/juridik që do të ofrojë kurse të formimit profesional duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë ambiente të përshtatshme, në mënyrë të tillë që për çdo vend trajnimi të ketë jo më shumë se 2 kursantë;

b) Pajisjet didaktike të nevojshme për kryerjen e aktivitetit;

c) Kapacitetet e nevojshme trajnuese. Instruktorët e punësuar duhet të kenë arsimin e lartë përkatës ose arsimin e mesëm profesional dhe jo më pak se 2 vjet eksperiencë pune në mësimdhënie. Për profesione të veçanta duhet të kenë arsimin e mesëm dhe të kenë kryer kurse afatmesme kualifikimi.

d) Numri i pjesëmarrësve në një kurs nuk mund të jetë më i madh se 15.

2. Subjektet fizike/juridike, që ofrojnë kurse të formimit profesional, licencohen pas shqyrtimit të dokumentacionit që ato duhet të paraqesin, si më poshtë:

a) Kërkesën për t'u pajisur me licencë (sipas modelit tip), bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) Programet e kurseve që ofrohen;

c) Vërtetimi i regjistrimit si ofrues i formimit profesional në zyrën përkatëse të punësimit;

d) Leja higjieno-sanitare;

e) Vërtetim nga dega përkatëse e tatimeve për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të personelit kualifikues, për periudhën që subjekti është i licencuar;

f) Ekstrakti i regjistrimit në QKR ose ekstrakti i vendimit të gjykatës të lëshuar nga QKR ku, në pikën "Fusha e veprimtarisë" të jetë shprehur si aktivitet formimi profesional për subjektet fizike/juridike ose vendimi i gjykatës për OJF-të;

g) Pronësinë apo marrjen me qira të ambienteve, të përshtatshme për kryerjen e aktivitetit, si dhe të pajisjeve didaktike të nevojshme.

3. Në formularin e vetëdeklarimit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) të deklarohet për:

a) Kryerjen e kurseve të formimit profesional për të cilat kërkon të licencohet;

b) Tarifën për çdo kurs të ofruar;

c) Personeli kualifikues të ketë diplomat dhe certifikatat përkatëse, të cilat tregojnë nivelin e kualifikimit të tij, për kursin që ai do të jetë instruktor;

d) Listën e qytetarëve të huaj të punësuar apo që ushtrojnë veprimtari për formim profesional në këto subjekte, si dhe lejen e punës, që ata kanë marrë në zyrën përkatëse të punësimit;

e) Informimin në mënyrë periodike mbi ecurinë e aktivitetit në zyrën përkatëse të punësimit dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP-në).

4. Zyra përkatëse e punësimit kryen kontrollin fizik të subjektit dhe kur konstaton se këto janë në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2, lëshon vërtetimin e regjistrimit të subjektit pranë kësaj zyre si ofrues i formimit profesional.

5. Dokumentet nga subjektet fizike/juridike dorëzohen në dy kopje (njëra origjinale dhe tjetra fotokopje) dhe depozitohen në sektorin e protokoll-arkivit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit, paraprakisht, shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe vlerëson se ai është i plotë sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, përgatit relacionin argumentues për licencimin e subjektit. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, SHKP njofton subjektin për mangësitë dhe vendos një afat për plotësimin e tij. Relacioni argumentues dhe kopje e dokumentacionit të subjektit dërgohet në Drejtorinë e Politikave të Punësimit në ministri, brenda 15 ditëve pune, nga momenti që subjekti ka dorëzuar dokumentacionin e plotë.

6. Drejtoria e Politikave të Punësimit, pasi e rishqyrton dokumentacionin e ardhur dhe konstaton se ai plotëson kriteret sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, përgatit licencën për subjektin brenda 5 ditëve pune dhe ia paraqet atë për miratim Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Në rast se subjektit i refuzohet dhënia e licencës, ai ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit për refuzimin e dhënies së licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

8. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shqyrton ankimimin dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të tij. Në rast se ankimimi nuk zgjidhet brenda këtij afati, si dhe në rastet kur ministri lë në fuqi vendimin për refuzimin e licencës, personi fizik/juridik mund të ankohet në gjykatën e shkallës së parë, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimit.

9. Licenca është e vlefshme për një periudhë kohore njëvjeçare nga data e dhënies së saj. Në rastet kur programet e kurseve janë dyvjeçare, licenca është e vlefshme për 2 vjet.

10. Nëse, gjatë kontrolleve fizike vihen re shkelje ose pasaktësi të dokumentacionit, të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, punonjësi i zyrës përkatëse të punësimit cakton një afat, brenda të cilit subjekti duhet të plotësojë mangësitë e konstatuara.

11. Nëse subjekti nuk plotëson brenda afatit të përcaktuar kërkesat e vendosura, i propozohet

ministrit heqja e licencës. Ministri shprehet brenda 10 ditëve punë nga dita e paraqitjes së propozimit. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e ministrit për heqjen e licencës, ai ka të drejtën e vazhdimit të procedurës së ankimit, sipas pikës 7 dhe 8 të këtij udhëzimi.

12. Në rastet e kërkesës për ripërtëritje licence, subjekti 10 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës, depoziton dokumentet në SHKP. Mosrespektimi i afatit të sipërpërmendur sjell humbjen e së drejtës për ripërtëritje licence. SHKP dhe Drejtoria e Politikave të Punësimit ndjekin procedurën e përshkruar në pikat 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

13. Vendimi për ripërtëritjen e licencës merret pas dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:

a) Kërkesën për t'u rilicencuar;
b) Programi i kurseve (vetëm në rastet kur ndryshon programi, kohëzgjatja dhe tipologjia e kursit);

c) Leja higjieno-sanitare;

d) Vërtetim nga dega përkatëse e tatimeve për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të personelit kualifikues për periudhën e licencimit.

14. Në rast se subjektit i refuzohet ripërtëritja e licencës, për mosplotësim të kërkesave të përcaktuara në pikat 1 dhe 13, ai ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit për refuzim, sipas procedurës së përcaktuar në pikat 7 dhe 8 të këtij udhëzimi.

15. Subjekti i licencuar duhet ta njoftojë me shkrim zyrën përkatëse të punësimit për datat e zhvillimit të testeve përfundimtare, të paktën dy javë përpara. Zyra përkatëse e punësimit, bashkëpunon me drejtorinë përkatëse rajonale të formimit profesional publik, aty ku ato janë të ngritura, ose Shërbimin Kombëtar të Punësimit nëse nuk ka drejtori rajonale të formimit profesional publik në territorin ku ushtron veprimtarinë ajo, për të dërguar përfaqësuesit e tyre që do të marrin pjesë në testimin e kursantëve.

16. Subjekti i licencuar, në përfundim të kursit, pajis kursantët me certifikatën përkatëse të firmosur dhe vulosur prej tij. Certifikata, ku vendoset numri dhe data e licencës së lëshuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, siglohet nga drejtori i zyrës përkatëse të punësimit.

17. Zyra përkatëse e punësimit ngarkon një punonjës për formimin profesional, për mbajtjen e një regjistri statistikor, për certifikatat e lëshuara, personat e trajnuar nga subjektet e licencuara.

18. Në fillim të çdo kursi subjekti i licencuar dërgon një listë të kursantëve pjesëmarrës në kurs, në zyrën përkatëse të punësimit. Gjithashtu, ai mban një regjistër amze për regjistrimin e kursantëve dhe një regjistër për zhvillimin e temave ditore sipas programit, mbarëvajtjen e çdo kursi, ku të shënohet prezenca dhe përparimi i kursantëve.

19. Tarifa për dhënien e licencës derdhet në financën e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe është 10 000 lekë dhe në rastet e ripërtëritjes së licencës tarifa është 5 000 lekë.

20. Monitorimi i subjekteve bëhet nga SHKP me zyrën përkatëse të punësimit në mënyrë periodike, por jo më pak se dy herë në vit, të cilët bëjnë raportin shoqëruar me rekomandime të detyrueshme. SHKP paraqet një informacion çdo 3 muaj në Drejtorinë e Politikave të Punësimit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në lidhje me ecurinë e formimit profesional në subjektet e licencuara sipas këtij udhëzimi.

21. Dosjet e dokumentacionit për licencimin e ofruesve të formimit profesional ruhen 5 vjet për subjektet me licencë 2-vjeçare dhe 3 vjet për subjektet me licencë 1-vjeçare.

22. Udhëzimi nr.437, datë 3.3.2003 "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional", ndryshuar me udhëzimin nr.318, datë 21.2.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.437, datë 3.3.2003 "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional" të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe urdhri nr.316, datë 21.2.2005 "Për tarifën e certifikatës" i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

KËRKESË PËR LICENCIM

**Drejtuar: Shërbimit Kombëtar të Punësimit
Drejtorisë së Formimit Profesional**

Tiranë

Unë i nënshkruari, lindur në dhe banues në, regjistruar në QKR me nr. NIPT-i (për subjektet fizike/juridike) ose ekstrakti i vendimit të gjykatës të lëshuar nga QKR me nr., datë..... (Për OJF-të), për ofrimin e kurseve të formimit profesional në fushën e

Po paraqes kërkesën për licencim të aktivitetit në fushën e formimit profesional në kurset e mëposhtme:

1.
2.
3. etj.

Kurset do të kenë një kohëzgjatje prej, me një total orësh prej

Kurset e formimit profesional do të zhvillohen në adresën:

Rr.....
Nr.tel/cel.....Fax.....,
e-mail..... (Nëse ka)

Bashkëlidhur kërkesës do të gjeni dokumentacionin sipas udhëzimit nr.1590, datë 4.8.2008 “Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”.

Me respekt

Emri, mbiemri, firma, vula e subjektit

Datë, më.....

FORMULAR TIP I VETËDEKLARIMIT

VETËDEKLARIM

Drejtuar: Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP)
Drejtorisë së Formimit Profesional
Drejtorisë së Politikave të Punësimit

Unë i nënshkruari deklaroj që jam banues në
Me adresë..... me seli..... Tel.
.....cel.....dhe me dokument identifikimi/nr. i pasaportës

1. Me nr.licence dhe datë (Nëse është rilicencim)

Në fushën e

.....
.....

Deklaroj që: Njoh dhe zbatoj udhëzimin nr.1590, datë 4.8.2008 “Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional” për sa më poshtë:

1. Kryerjen e kurseve të formimit profesional për të cilat kërkoj të licencohem;
2. Tarifën për çdo kurs të ofruar;
3. Personeli kualifikues ka diplomat dhe certifikatat përkatëse, të cilat tregojnë nivelin e kualifikimit të tij, për kursin që do të jetë instruktor;
4. Listën e qytetarëve të huaj të punësuar apo që ushtrojnë veprimtari për formim profesional në këto subjekte si dhe lejen e punës, që ata kanë marrë në zyrën përkatëse të punësimit.
5. Informimin në mënyrë periodike mbi ecurinë e aktivitetit në zyrën përkatëse të punësimit dhe SHKP.

Deklaroj:

Që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe do të mbaj përgjegjësinë time si subjekt juridik/fizik. Në rast se nuk zbatoj apo kam dhënë informacion të rremë, atëherë do të përballem me ligjin në fuqi për raportim të këtyre të dhënave.

Emri, mbiemri, firma

VENDIM
Nr.42, datë 16.7.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E
NUMRIT NDËRKOMBËTAR TË LLOGARISË BANKARE (IBAN)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja ”b”; nenit 3, pika 2 dhe pika 4, shkronja ”dh”; nenit 12 shkronja ”a”, nenet 21 e 43, shkronja ”c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 53, pika 4; nenit 124 dhe atij 129 pika 6 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për strukturën dhe përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.38, datë 3.5.2000, i ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.50, datë 20.06.2001 “Për miratimin e skemës për përcaktimin e KIB për bankat e nivelit të dytë”.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë ditë) pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYETAR
Fatos Ibrahimi

RREGULLORE
PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E NUMRIT NDËRKOMBËTAR
TË LLOGARISË BANKARE (IBAN)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës së numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare - IBAN, i marrëdhënieve ndërmjet bankës dhe/ose degës së bankës së huaj dhe klientëve të tyre në lidhje me krijimin, komunikimin, njohjen dhe përdorimin e IBAN-it në Republikën e Shqipërisë, si dhe i procedurave për kontrollin e vlefshmërisë së tij prej tyre.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

- a) ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) rregulloren “Për sistemin dhe instrumentet e pagesave”;
- d) akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit të pagesave.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Subjekte të zbatimit të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me IBAN-in në rolin e operatorit për kryerjen e pagesave për klientët e saj.

Neni 4

Përkufizime

1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) Bankë - janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe veprimtari financiare, në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe Banka e Shqipërisë në rolin e operatorit të pagesave për klientët e saj.

b) BBAN – (Basic Bank Account Number) është numri bazë i llogarisë bankare, i cili përfaqëson një sekuençë alfanumerike (kod identifikues), të përdorur nga institucionet financiare në vende të ndryshme, pjesë e skemës kombëtare të përcaktimit të numrit të llogarive bankare, i cili identifikon në mënyrë unike një llogari të një klienti, në një institucion financiar.

